

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ME ORTAK TË VETËM
“VIRAL SOLUTIONS” Sh.p.k.

Sot, më datë 07.06.2022 në Tiranë (Shqipëri), sipas ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, me vullnetin e lirë dhe të plotë të shprehur në këtë akt, ortaku i vetëm i shoqërisë së re të themeluar “Viral Solutions” Sh.p.k, Z. Dritan Spaho, harton këtë Statut për sa vijon:

Neni 1

Emri i Shoqërisë

Shoqëria emërtuar “Viral Solutions” Sh.p.k.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, person juridik, do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (“QKB”) me emrin “Viral Solutions” Sh.p.k.

Neni 2

Selia

Shoqëria e ka selinë ligjore në Rruga “Frang Bardhi”, Shk. 3, Apt. 9/3, D5, Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë QKB për një kohëzgjatje të pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitet juridik nga momenti i regjistrimit në QKB Tiranë.

Neni 4

Objekti i Shoqërisë

4.1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e shërbimeve në fushën e industrisë elektronike dhe IT



për llogari të saj dhe të tretëve;

- 4.2. Të gjitha këto aktivitete duhet të përmbushen brenda limiteve dhe normave që rregullojnë veprimtarinë si dhe të atyre të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

- 5.1. Kapitali i Shoqërisë tregtare "Viral Solutions" Sh.p.k. është ALL 500,000 (pesëqind mijë lekë). Kapitali i shoqërisë konsiston në 1 (një) kuotë;
Kuota të cilat zotërohet nga ortaku i vetëm:
- Z. Dritan Spaho me 100% e kapitalit të shoqërisë;
- Kapitali fillestar i Shoqërisë mund të zmadhohet apo zvogëlohet dhe është tërësisht i likuidueshëm dhe i nënshkrueshëm.
- 5.2. Kuotat e kapitalit derdhen në bankë, në llogarinë rrjedhëse në emër të Shoqërisë dhe kuotat e derdhura do të regjistrohen në librin e llogarive të shoqërisë;
- 5.3. Ortaku ka të drejtën të tërheqë fondet e depozituara si kapital fillestar të Shoqërisë, në rastin në të cilin Shoqëria nuk regjistrohet në QKB brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e depozitimit të fondit.


Neni 6

Transferimi i Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë

- 6.1. Transferimi i kuotave është i vlefshëm vetëm në rast se rezulton se janë respektuar dispozitat e këtij neni;
- 6.2. Në rast transferimi të kuotave midis të gjallëve me akt, në rast se ortakët janë më shumë se një, këtyre të fundit u takon e drejta e parablerjes së kuotave të shoqërisë. Ortaku shitës, si fillim duhet t'i bëjë një ofertë ortakëve të tjerë me letër rekomande, në të cilën të përcaktojë çmimin e kërkuar për shitjen e kuotës së tij. Në këtë rast secili nga ortakët, në proporcion me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë, gëzon të drejtën e parablerjes dhe në rast kur vendos ta ushtrojë

këtë të drejtë duhet t'i dërgojë ortakut shitës një deklaratë të shkruar brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e ofertës;

- 6.3. Në rast mosmarrëveshesh mbi çmimin e kërkuar, me kërkesë të palëve të interesuara, çmimi do të përcaktohet nga një ekspert kontabël i miratuar me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Ortakëve, i cili do të përcaktojë çmimin e shitjes në bazë të vlerës reale të kuotave;
- 6.4. Në rast mosmarrëveshjeje mbi emërimin e ekspertit kontabël, i cili do të emërohet me shpenzime të secilës palë, me kërkesë të palës së interesuar do të zgjidhet nga Gjykata e vendit ku ka selinë shoqëria;
- 6.5. Eksperti duhet të kryejë vlerësimet sipas kriterëve dhe mënyrave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar;
- 6.6. Pas vlerësimit të kuotave nga ana e ekspertit, si shitësi por ashtu edhe blerësi, kanë të drejtë të tërhiqen përkatësisht nga shitja dhe blerja duke ia komunikuar ortakëve të tjerë të shoqërisë. Në këtë rast shpenzimet e ekspertit do të jenë në ngarkim të palës që tërhiqet;
- 6.7. E drejta e parablerjes që nuk shfrytëzohet nga njëri prej ortakëve, i transferohet ortakëve të tjerë, gjithmonë në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë;
- 6.8. Ortaku shitës i kuotave duhet t'i transferojë këto të fundit me akt noterial ortakëve blerës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga deklarimi për parablerjen nga ana e ortakëve blerës dhe në rast të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditë nga dita e vlerësimit;
- 6.9. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet brenda një periudhe 30 (tridhjetë) ditore duke filluar nga data e njoftimit të ofertës ose brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e përcaktimit të çmimit nga ana e ekspertit kontabël të emëruar. Pasi kanë kaluar afatet e mësipërme, shitësi ka të drejtën të transferojë tek palë të treta kuotën e tij.



6.10. Të tretët marrin në zotërim kuotën sipas një kontrate me shkrim dhe në vijim të aprovimit me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për shitjen e kuotës.

Neni 7

Fitimet e Shoqërisë

Fitimet e Shoqërisë i takojnë ortakëve të saj. Asambleja vendos sipas ligjit për ndarjen ose ri qarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat, në bazë të përqindjes së kuotës së nënshkruar.

Neni 8

- 8.1. Shoqëria "Viral Solutions" Sh.p.k. do të përdorë dhe disponojë pasurinë e saj të akumuluar. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale ose jo materiale, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurisë së akumuluar tek të tretët.
- 8.2. Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria "Viral Solutions" Sh.p.k. gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Rreziku i kapitalit

- 9.1. Shoqëria "Viral Solutions" Sh.p.k vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimit vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj të nënshkruar. Ortakët mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në të.

Neni 10

Drejtimi dhe administrimi i Shoqërisë

- 10.1. Bëjnë pjesë në detyrat dhe kompetencat e ortakut të vetëm, të mbledhur në Asamblenë e Përgjithshme, të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në këtë Statut. Ndër këto detyra përfshihen:
1. ndryshimi i statutit;
 2. miratimi i buxhetit vjetor të raporteve të administratorëve;

3. emërimi e shkarkimi i administratorëve ortakë ose jo dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se, qoftë për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht motivi;
4. miratimi i huave dhe garancive, hapja e llogarive bankare dhe marrjen e huave dhe kredive;
5. përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së Shoqërisë;
6. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
7. vendimi lidhur me krijimin apo mbylljen e degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjencive të Shoqërisë;
8. vendimi për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
9. vendimi për fillimin apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është e përfshirë Shoqëria, duke autorizuar administratorin e Shoqërisë për të vepruar;
10. vendimi për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
11. vendimi për ndarjen e kuotave dhe për anulimin tyre sipas ligjit;
12. vendimi për miratimin dhe ndryshimin e procedurës për mbledhjen e asamblesë;
13. vendimi për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të Shoqërisë nga Administratori;
14. vendimi për transferimin e kuotave;
15. vendime për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
16. marrjen e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.

Për sa kohë që shoqëria do të kontrollohet nga ortakët, vendimet e asamblesë do të regjistrohen në regjistrin përkatës, ashtu siç parashikohet edhe nga ligji.

Neni 11

Thirrja e Asamblesë së ortakëve

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga Administratori drejt Ortakut të Vetëm me shkresë ose e-mail në adresat e ortakut apo ortakëve të depozituara pranë shoqërisë.



Njoftimi për mbledhjen e asamblesë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet të gjithëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit të lartpërmendur, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord për të marrë këto vendime.

Vendimet e marra të Asamblesë së Përgjithshme do të duhet t'i komunikohen në kohë edhe Administratorëve që mungojnë.

Asambleja do të duhet të mbledhet të paktën një herë në vit për aprovimin e bilancit.

Neni 12

Quorum-i për diskutimin dhe vendimmarrjen

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të veçantë. Pjesëmarrja dhe votimi përkatës në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të kryhen edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Në këtë rast, është e nevojshme prezenca direkte apo indirekte (skype, video dhe të ngjashme) e një sekretari për krijimin e dokumentit përfundimtar të Asamblesë.

Procesverbali i vendimeve duhet t'i jepet Administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të mbahet në selinë ligjore të Shoqërisë nën kujdestarinë e tij.

Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast, vendimet që merren kur mbledhja kryhet jashtë territorit të Shqipërisë, do t'u nënshtrohen legjislacionit shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Shqipëri dhe do të duhen në përputhje me normativën e këtij Statuti për sa i përket quorum-it dhe shumicës për të marrë vendimmarrje.

Quorum-i i kërkuar për të vlefshmërinë e mbledhjes së asamblesë së ortakëve është ai i parashikuar nga neni 87 i Ligjit nr. 9901/2008, i ndryshuar.

Neni 13

Administrimi i Shoqërisë

Administrator i parë i Shoqërisë emërohet:



Ervin Spaho, lindur në Sul, Devoll (Shqipëri), më datë 28.05.1984, me vendbanim në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit me nr. I40528032U, lëshuar më datë 24.06.2014, e vlefshme deri më datë 23.06.2024;

Administratorët emërohen për një afat 3 (tre) vjeçar duke filluar nga data e regjistrimit të Shoqërisë pranë QKB, me të drejtë riemërimi nga Asambleja e Ortakëve. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të revokojë Administratorin para mbarimit të mandatit. Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen e parakohshme, përpara mbarimit të mandatit, me njoftim drejtuar Asamblesë së Ortakëve sipas procedurave të parashikuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë edhe më shumë se një administrator, të çfarëdo kombësie dhe të jashtëm për Shoqërinë. Në rastin e emërimit të më shumë administratorëve në fuqi, secili nga administratorët mund të ushtrojë të gjitha tagrat e përfaqësimit dhe të firmës në limitet e përcaktuara nga Asambleja e Ortakëve ashtu si rezultojnë në aktin e emërimit të tyre, regjistruar pranë QKB-së. Secili prej tyre do të jetë individualisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të dhëna nga ligji dhe ortakët administratorit.

Çdo Administrator duhet t'i komunikojë çdo tre muaj, ortakëve dhe administratorëve të tjerë veprimet nga ai të kryera brenda fushës së kompetencave që i janë dhënë.

Neni 14

Detyrat dhe funksionet e administratorit

Administratori ka për detyrë të menaxhojë shoqërinë ashtu si edhe është përkufizuar në objektin social, duke respektuar legjislacionin dhe direktivat e cituara nga Asambleja e Ortakëve.

Çdo administrator kryen detyrat e përkufizuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë në këtë statut. Ndër këto, thjesht si tregues, përshihen këto detyra:

- punësojë dhe pushojë nga puna, të mbajë raporte me Administratën publike shqiptare, të hartojë dhe të paraqesë për miratim në asamblenë e ortakëve projektin për bilancin vjetor sipas normativës së parashikuar nga legjislacioni dhe nga statuti;
- të hartojë buxhetin ekonomik financiar dhe pasuror të shoqërisë dhe bilancin e mbylljes

se aktivitetit financiar te vitit paraardhës dhe t'ja paraqesi asamblesë së ortakëve të gjithë dokumentacionin e nevojshëm brenda afatit të mbylljes së vitit financiar;

- të hartojë çdo muaj raporte për ecurinë ekonomike dhe financiare dhe tja paraqesë ortakëve;

Të kryejë pagesat për:

- taksat shtetërore dhe të institucioneve vendore;
- kontributet sociale dhe shëndetësore;
- pagat për punonjësit e Shoqërisë; dhe
- faturave dhe/ose çdo lloj tjetër detyrimi të jashtëm që lind për Shoqërinë sipas modaliteteve të parashikuara më poshtë.

Për çdo rast Administratori do t'i duhet të ketë qasje dhe është i vetmi përgjegjës në të dhënat e-banking (llogari hyrëse dhe fjalëkalimi) lëshuar nga Banka/t nga ku do të hapen llogaritë bankare të Shoqërisë. Administratori për çdo veprimtari në llogarinë rrjedhëse bankare të Shoqërisë, si dhënie e ceqeve, hapjen e linjave të kredisë, kredive (apo veprime të tjera bankare) dhe gjithsesi përveç kompetencave të listuara më sipër, para se të veprojnë, do t'i duhet të marrë aprovimin me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 15

Të Drejtat e Shoqërisë

15.1. Shoqëria ka të drejtë:

1. të kryejë veprimtari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
2. të marrë kredi në Lekë dhe në valutë të huaj, nga Bankat vendase ose të huaja, apo edhe nga ortakët në bazë të rregullave ligjore dhe të statutit;
3. të përfitojë nga favorët që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera;
4. të investojë kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
5. të punësojë punëtoare, vendas ose të huaj;
6. ti paguajë dividendët ortakëve;

7. të zhvillojë aktivitetin në emër e për llogari të ortakëve dhe shoqërive të tjera të grupit në të cilin bën pjesë.

Neni 16

Detyrat e Shoqërisë

16.1. Shoqëria ka për detyrë:

1. të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
2. të derdhi në llogaritë bankare të Shoqërisë në Euro/Lekë për të përmbushur detyrimet e Shoqërisë;
3. të sigurojë punonjësit e saj;
4. të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
5. të pajiset me leje dhe/ose autorizime të mundshme, nëse kërkohen nga ligji, për të zbatuar objektin e veprimtarisë së saj;
6. të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj;
7. të rimbursojë huatë e marra kundrejt të tretëve dhe/ose ortakëve.

Neni 17

Marrëdhëniet ekonomike – financiare të Shoqërisë

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj dhe prospekteve financiare.

Neni 18

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të cilit, brenda datës 31 mars të çdo viti nxirret bilanci vjetor i Shoqërisë, i cili mbahet pranë selisë së shoqërisë për arsyen e konsultimit mes ortakëve në mbledhjen e asamblesë.



Neni 19

Viti financiar, duke përjashtuar vitin e parë të aktivitetit, fillon më 1 janar të çdo viti dhe mbaron më 31 dhjetor të të njëjtit vit. Viti i parë do të fillojë në datën e themelimit të shoqërisë deri më 31 dhjetor 2022.

Neni 20

Shoqëria, me anë të Administratorit të saj, mban një apo disa llogari në Bankë. Llogaritë mbahen në Lekë dhe/ose Euro dhe pasqyrohen në librat kontabël përkatës. Për hapjen e çdo llogarie bankare të Shoqërisë, autorizohet administratori i emëruar.

Neni 21

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit financiar, Shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë 5% të fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezervë e domosdoshme", derisa ky fond të arrijë masën 10% të kapitalit themeltar.

Neni 22

Dispozita të veçanta

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa të zakonshme, të realizuar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe mund të ketë një markë të vetën. Në rast të krijimit të një faqe interneti, mund të deklarohet në mënyrë vullnetare në QKB.

Neni 23

Shndërrimi

Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri të llojeve të tjera, mund të behët me vendim të ortakëve themelues sipas mënyrave të parashikuara në ligj.



Neni 24

Prishja e Shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë, mund të vijë për shkaqet e parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar dhe për arsytet si më poshtë:

- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në aktin e themelimit të saj;
- me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- me vendim të gjykatës;
- humbja e kapitalit të shoqërisë;

Në këto raste, ortakët i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së Shoqërisë deri sa ajo t’u dorëzohet personave përkatës fizike e juridike, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tretë.

Në rast se fondet e disponueshme, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë, likuidatori mund t’i kërkojë ortakëve themelues të Shoqërisë që të derdhë tërësisht kuotat që u takojnë, nëse nuk janë derdhur deri në atë moment.

Neni 25

Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksioni

Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakëve, midis ortakëve dhe Shoqërisë, midis Shoqërisë dhe Administratorit do t’i nënshtrohen për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.

Neni 26

Ky statut përpilohet në 4 (katër) ekzemplare në gjuhën shqipe dhe të nënshkruara rregullisht nga ortakët i vetëm në këtë akt.

Dispozitat të fundit

Për regjistrimin e aktit të themelimit dhe të këtij statuti në QKB, sipas nenit 26 të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për QKB- në", autorizohet Administratori I Shoqërisë ose person i autorizuar prej tij, për të kryer çdo veprim të nevojshëm pranë QKB-se dhe çdo institucioni publik.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Z. Dritan SPAHO

Dritan Spaho

